



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300425/12

Tiranë ___/___/2023

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personave përgjegjës efektivë të strukturave të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë për mos zbatimin e detyrimeve ligjore për dokumentimin e veprimit të shoqërimit të shtetasve V.B. dhe 9 shtetasve të tjerë në datën 13.05.2023.*

KOMISARIATIT TË POLICISË
Himarë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Vlorë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

Në kuadër të ushtrimit të detyrës kushtetuese, institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me iniciativë rastin e bërë publik në mediat sociale në datën 14.05.2023. Sipas mediave, shtetësja V.B. nga qyteti i Himarës ka bërë publik shqetësimin e saj lidhur me shoqërimin në organin e policisë. Ajo është shprehur se në orën 02:00, të datës 13.05.2023, i kanë shkuar në banesë disa punonjës policie dhe i kanë kërkuar që të shkonte me ta në polici së bashku me djalin 18 vjeç. Pas kërkesës së punonjësve të policisë, ajo dhe djali i saj janë shoqëruar në Komisaratin e Policisë Vlorë ku janë pyetur në lidhje me çështjen e blerjes së votave nga kandidati për Bashkinë e Himarës i koalicionit "Bashkë fitojmë", Fredi Beleri. Pasi u janë marrë deklaratimet, punonjësit e policisë i kanë lënë të lirë ata dhe nuk i kanë përcjellë për në banesë. Sipas ankueses, ajo nuk kishte marrë para me vete sepse nuk ishte në dijeni të faktit që do ta shoqëronin në

Komisariat e Policisë Vlorë dhe në këto rrethana është detyruar që të gjejë lekë hua për t'u kthyer në banesën e saj në Himarë.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, bazuar në nenin 63, paragrafi i katërt i Kushtetutës, ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, respektivisht në nenin 19, gërma “b” të ku parashikohet se: *“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”* dhe në nenin 20 ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror”*, i kërkuam këtij organi që të na dërgonte një informacion lidhur me këtë rast të bërë publik në media.

Pas dërgimit të shkresës tonë, Komisarati i Policisë Himarë me shkresën nr. 487/1 prot., datë 06.06.2023, na informoi se punonjësit e policisë së këtij organi në bazë të një urdhri për nevoja pune kanë shoqëruar disa persona për llogari të Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) Vlorë ndër të cilët ka qenë edhe shtetësja V.B.. Gjithashtu u informuam se ky komisarati ka zbatuar një urdhër për shoqërimin e tyre në DVP Vlorë dhe nuk ka asnjë informacion për arsyen e shoqërimit dhe vijueshmërinë e veprimeve të kryera me këtë shtetase.

Sqarojmë se, në kuadër të hetimit administrativ të nisur nga ana jonë, kërkesën për informacion ia dërguam DVP Vlorë, ndaj do të ishte korrekte që përgjigjen të na e kthente kjo drejtori. Për më tepër nevojën e kthimit të kësaj përgjigjeje nga DVP Vlorë e konfirmoi edhe përgjigjja e dërguar nga Komisarati i Policisë Himarë, të cilën e cituam më sipër, sipas të cilës ky organ ka zbatuar një urdhër të organit epror për shoqërimin e disa personave në DVP Vlorë dhe se nuk kishin informacion për arsyet e shoqërimit dhe veprimet e kryera në vijim me këta shtetas.

Për sa më sipër, me shkresën nr. K2/I11-4 prot., datë 13.06.2023, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, i kërkuam të na dërgonte brenda 5 ditëve një informacion lidhur me pyetjet si më poshtë:

1. Cilat janë arsyet dhe baza ligjore e shoqërimit të shtetases V.B. në DVP Vlorë në datën 13.05.2023?
2. Çfarë veprimesh procedurale janë kryer me ankuesen dhe me çfarë cilësie është pyetur ajo?
3. Cilat janë arsyet ligjore dhe ngutja për të kryer këtë veprim në orën 02:00 të datës 13.05.2023?

4. A është regjistruar shtetësja V.B. në regjistrin e personave të shoqëruar në organin e policisë (Komisariatit e Policisë Vlorë)?

5. Nëse po, na dërgoni fotokopje të njëzuar të fletës se këtij regjistri ku janë pasqyruar të dhënat lidhur me këtë shtetase.

6. A i është mbajtur e dhënë asaj kopja e proceverbalit “Për veprimet e kryera me të shoqëruarin”?

7. Nëse po, na dërgoni fotokopjen e njëzuar të këtij procesverbali.

Ndonëse me vonesë, DVP Vlorë me shkresën nr. 3805/1 prot., datë 31.07.2023 na informoi se:

Strukturat e Hetimit të Krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, në funksion të hetimeve proaktive regjistruar për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, në vijim të detyrës së lënë nga prokurori i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 13.05.2023, rreth orëve të para të mëngjesit, kanë shoqëruar në ambientet e DVP Vlorë shtetasen V.B., me qëllim marrjen e të dhënave si person që tregon rrethana të hetimit në funksion të një procedimi penal. Ky veprim është kryer në zbatim të nenit 30, pika 2 “Funksionet e policisë gjyqësore” të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu u informuam se, për shkak të dinamikës së hetimit, gjendjes së flagrancës (Neni 252 i Kodit të Procedurës Penale), mbledhjes dhe administrimit të provave, dëshmime, në kohë sa më të shpejtë, është kryer marrja e të dhënave shtetases V.B. gjatë orëve të para të mëngjesit të datës 13.05.2023. Procesverbali i deklaramit si person që tregon rrethanat e hetimit, është vënë në dispozicion të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë së bashku me materialet e tjera procedurale.

Përveç sa më sipër, në këtë shkresë u informuam se shtetësja V.B. nuk është shoqëruar në ambientet e shoqërimit të DVP Vlorë, dokumentuar kjo edhe me fotokopje të regjistrin të hyrje-daljeve, por është pyetur si person që tregon rrethanat e hetimit në funksion të hetimeve proaktive nga oficerët e policisë gjyqësore që kanë ndjekur hetimin dhe pas përfundimit të veprimeve procedurale është shoqëruar jashtë ambienteve të këtij organi.

Ndërsa me shkresën nr. 3389/1 prot., datë 10.10.2023, të DVP Vlorë, ndërmjet të tjerave u informuam se, veprimet e kryera nga strukturat e këtij organi në datën 13.05.2023 rreth orëve të para të mëngjesit për shoqërimin dhe pyetjen e shtetases V.B. janë bërë në vijim të detyrës së lënë në mënyrë verbale nga prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në funksion të hetimeve proaktive të regjistruara për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal.

Gjithashtu, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr.11769/1 prot., datë 23.11.2023, na informoi se ka regjistruar kallëzimin penal nr. 618, datë 08.05.2023, mbi bazën e referimit të bërë nga DVP Vlorë për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal.

Nisur nga gjendja e flagrancës në kuadër të këtij procedimi penal, nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore janë kryer veprimet e para hetimore për grumbullimin, administrimin e provave, marrjen e deklarimeve nga persona që kanë dijeni për veprën penale, ushtrimin e kontrolleve, etj. Nga ana e tyre janë marrë deklarime në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale edhe shtetas V.B..

Shërbimet e policisë pranë DVP Vlorë kanë kryer detyrat e tyre të parashikuara në nenet 30, 294 e vijues të Kodit të Procedurës Penale me qëllim pyetjen e personave që tregojnë rrethanat e faktit penal. Policia gjyqësore ka për detyrë të kryejë veprime hetimore të nevojshme me inivciativën e saj dhe kryen çdo veprim të urdhëruar ose të deleguar posaçërisht nga prokurori. Urdhrat e prokurorit në kushtet e flagrancës mund të jenë verbale ose me shkrim, sipas dinamikës së hetimit.

Përveç sa më sipër, në këtë shkresë u informuam se ky organ ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe ka dërguar aktet e hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 489, të viti 2023, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë.

Nga përgjigjet e cituara më lart rezulton se shtetësja V.B. gjatë orëve të para të mëngjesit të datës 13.05.2023 është shoqëruar nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Himarë nga banesa e saj për në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë. Shoqërimi i saj në organin e policisë është bërë në vijim të detyrës së lënë nga prokurori i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për nevoja pune në funksion të hetimeve proaktive regjistruar nga ky organ për veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal. Qëllimi i shoqërimit të kësaj shtetaseje si dhe i disa shtetasve të tjerë, ka qenë marrja e të dhënave në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit të procedimit penal.

Ndërsa nga kopja e dokumentit (regjistrin të hyrje-daljeve), të dërguar nga DVP Vlorë së bashku me përgjigjen, rezulton se shtetësja V.B. është lënë e lirë në orën 11:33 të datës 13.05.2023.

Ndërkohë konstatojmë se referuar regjistrin të hyrje-daljeve të shtetasve në këtë organ, së bashku me shtetasen V.B., në DVP Vlorë janë shoqëruar edhe 9 shtetas të tjerë me banim në Himarë dhe Dhërmi. Të gjithë këta shtetas janë shoqëruar në kuadër të hetimit të një procedimi penal.

Ne çmujmë se do të ishte humane dhe dinjitoze që pas shoqërimit në orët e natës, marrjes së deklarimeve dhe kryerjes së veprimeve të tjera hetimore e procedurale me të shoqëruarit, si dhe mbas qëndrimit për rreth 10 orë në gjendje shoqërimi në organin e policisë, ata duhet të ishin dërguar në vendbanimet e tyre me mjetet e policisë, duke u kursyer kohë dhe shpenzime financiare.

Përveç sa më sipër nga përgjigjet e dërguara nga DVP Vlorë konstatojmë se ka një mos përputhje lidhur me faktin/masën e shoqërimit të shtetas V.B.. Konkretisht, në përgjigjen e dërguar me shkresën nr. 3805/1 prot., datë 31.07.2023 pretendohet se shtetësja V.B. nuk është shoqëruar në ambientet e shoqërimit të DVP Vlorë dhe si e tillë nuk konsiderohet e shoqëruar. Ndërsa në përgjigjen e dërguar me shkresën nr. 3389/1 prot., datë 10.10.2023, rezulton se ajo është shoqëruar në ambientet e kësaj drejtorie.

Referuar përgjigjes së parë dhe meqënëse marrja e shtetas V.B. nga banesa dhe dërgimi në DVP Vlorë nuk është konsideruar shoqërim, nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Himarë të cilët kanë kryer këtë veprim ndaj saj dhe ndaj 9 personave të tjerë, si dhe punonjësit e DVP Vlorë/Komisariatit të Policisë Vlorë, ku personat në fjalë janë mbajtur në gjendje shoqërimi, nuk janë zbatuar detyrimet e parashikuara në aktet normative të cilat parashikojnë e rregullojnë shoqërimin e shtetasve në mjediset/ambientet e policisë.

Gjatë veprimtarisë së përditshme për ruajtjen e rendit, sigurisë publike, si dhe për përmbushjen e përgjegjësiave policore e të detyrave të tjera, punonjësve të policisë u lind nevoja për të kryer shoqërimet e shtetasve të ndryshëm në ambientet/mjediset e strukturave vendore të Policisë së Shtetit, si të stacioneve/komisariateve/drejtorive apo në institucione të tjera. Por, gjatë shoqërimit të shtetasve punonjësit e policisë duhet të zbatojnë me rigorozitet kriteret e shoqërimit dhe të drejtat e të shoqëruarve të parashikuara në aktet normative në fuqi.

E drejta e punonjësve të Policisë së Shtetit për të bërë shoqërimin e shtetasve në mjediset/ambientet e këtij organi, rastet dhe qëllimi i aplikimit të kësaj mase administrative e kufizimit të lirisë, përgjegjësitë e punonjësve të policisë në rastet e shoqërimit, zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria e personave të shoqëruar, dokumentimi i shoqërimit në polici dhe rregullat e shoqërimit, janë parashikuar në mënyrë të qartë në nenet 6/25¹, 109² dhe 122/1³ të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e

¹ “Shoqërimi” është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji.

² 1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:

- a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
- b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj;
- c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale;
- ç) për të parandaluar kryerjen e një veprë penale;
- d) kur është larguar pas kryerjes së një veprë penale;

Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Procedurën standarde të punës: “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit⁴.

Ndërsa në mënyrë të detajuar procedura e dokumentimit të veprimit të shoqërimit parashikohet në Kreun VII⁵ të Procedurës së cituar më sipër.

dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;

e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimit e tij në organin kompetent;

ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;

f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

2. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.

3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.

4. Efektivi i policisë njofton menjëherë qendrën operative për gjenealitetet e personit të shoqëruar, kur ato njihen, orën e saktë të shoqërimit dhe shkaqet e tij. Të dhënat e komunikuar nga efektivi i policisë hidhen menjëherë në sistemin elektronik të mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave. Mosrespektimi nga efektivi i policisë i detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

5. Punonjësi i policisë, dokumenton në procesverbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.

6. Punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë eprorin e vet ose institucionin e interesuar për sqarimin e çështjes. Të dhënat e veprimeve të kryera me personat e shoqëruar dokumentohen gjithashtu në regjistrat/librat që mbahen për këtë qëllim në ambientet e policisë ku është bërë shoqërimi i personit.

7. Për rastet e shoqërimit për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, për dëbimin ose ekstradimin, procedurat dhe afatet e mbajtjes përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

8. Rregullat teknike të shoqërimit, evidentimit, mbajtjes dhe trajtimit të personave të shoqëruar në ambientet e policisë përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

³ 1. Masat mbrojtëse merren ndaj personit të sëmurë mendor, në gjendje të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit me sëmundje ngjitëse të rënda. Në këto raste, punonjësi i policisë e dërgon personin në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit ose e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës.

2. Punonjësi i policisë merr masat e nevojshme për mbrojtjen e personit, gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tij dhe për këtë arsye mund t'i shkaktojë dëmtime fizike ose të përbëjë rrezik për jetën e tij ose të tjerëve.

3. Mbajtja e personit në ambientet e policisë vazhdon për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 10 orë.

4. Për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, punonjësi i policisë mund të bëjë kontrollin dhe këqyrjen fizike të këtyre personave, në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

5. Veprimet e mësipërme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në këtë dispozitë, dokumentohen në procesverbal. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi/at që kanë qenë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit, ndaj të cilit janë marrë masat mbrojtëse, ose familjarit/kujdestarit të tij.

⁴ Kreu IV “Rastet dhe qëllimi i aplikimit të shoqërimit”

Akti/veprimi i shoqërimit të detyrueshëm si akt i shtrëngimit personal, mund të kryhet vetëm kur ekzistojnë kushtet e rastet e përcaktuara në ligj, si:

A. Për identifikimin e personit;

B. Si masë mbrojtëse;

C. Ekzekutimin e një urdhri apo detyrimi të njohur me ligj;

D. Sqarimin e një rrethane.

⁵ VII. “Procedura e dokumentimit të veprimit të shoqërimit”

Akti/veprimi i shoqërimit, detyrimisht, evidentohet e dokumentohet në sistem elektronik, në regjistra, në formularë dhe procesverbale.

Procedura e evidentimit të veprimeve që janë kryer me të shoqëruarin kryhet nga punonjësi i policisë që ka punuar dhe sqaruar çështjen, ndërsa hedhja e të dhënave në regjistër dhe në sistemin elektronik të të dhënave kryhen nga punonjësi i policisë të shërbimit të informacionit në njësinë policore.

Mos zbatimi i kësaj kërke nga personat përgjegjës për dokumentimin e aktit të shoqërimit, përbën shkelje të rëndë disiplinore.

1. Evidentimi i veprimeve dhe të dhënave, që kryhen me personat e shoqëruar bëhet në rrugë:

- a. Manuale,
- b. Elektronike.

a. Dokumentimi i të dhënave në rrugë manuale kryhet në:

a.1 Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar dhe pjesë e pandarë e kësaj procedure (*Lidhja model 1*).

a.2 Formularin e Raportit të Shoqërimit, sipas tipit/modelit të miratuar me urdhër të DPPSH (*Lidhja model 2*).

a.3 Procesverbalin e veprimeve të kryera me personin e shoqëruar dhe pjesë e pandarë e kësaj procedure (*Lidhja model 3*).

a.4 Regjistrin e marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar gjatë kryerjes së veprimeve në ambientet e policisë dhe pjesë e pandarë e kësaj procedure (*Lidhja model 4*).

a.5 Regjistrin e Evidentimit të Dhënave për Personat e Shoqëruar të Mitur dhe pjesë e pandarë e kësaj procedure (*Lidhja model 5*).

a.1.1 - Hedhja e të dhënave në Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për personat e Shoqëruar kryhet nga punonjësi i shërbimit të funksionit: ndihmës specialist për informacionin të strukturave të rendit publik të njësisë policore.

Këto të dhëna hidhen menjëherë dhe pa vonesë në regjistër pas mbërritjes/shoqërimit të personit nga punonjësi i policisë dhe akomodimit të tij në ambientet e shoqërimit.

a.1.2 - Regjistri i Evidentimit të Personave të Shoqëruar:

a.1.3 - Regjistri i Evidentimit të Personave të Shoqëruar mbahet dhe është pjesë e dokumentacionit të punës së funksionit policor: ndihmës specialist për informacionin/përgjegjës për informacionin apo punonjësi i ngarkuar me këtë detyrë, në strukturat e rendit publik, është i tipit dhe modelit të përcaktuar (sipas lidhjes nr. 1), i cili para se të vihet në përdorim protokollohet në arshivë/sekretarinë e njësisë policore.

a.1.4 - Për personat e shoqëruar, evidentohen të dhënat e mëposhtme :

- a. Emri, atësia, mbiemri, datëlindja, vendlindja.
- b. Adresa e saktë e vendbanimit.
- c. Pamja e jashtme e personit duke përfshirë dhe shenja të veçanta që mund të kenë (*me një dorë apo një sy, shenja djegieje apo plage, tatuazhe, nishane etj*)
- d. Puna apo veprimtaria që kryen.
- e. Arsyet e shkaqet e shoqërimit.
- f. Drejtorinë/komisariat/stacionin e policisë dhe zyrën përkatëse ku është kryer shoqërimi.
- g. Emrin, mbiemrin e funksionin e punonjësit të policisë që ka kryer shoqërimin.
- h. Ora, data e shoqërimit.
- i. Ora, data e lënies së lirë të personit.
- j. Punonjësi i policisë që punoi për verifikimin e zgjidhjen e çështjes së personit të shoqëruar.
- k. Të dhënat për realizimin e të drejtës për njoftimin e familjarëve/afërmve për shoqërimin si: emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar për faktin e shoqërimit dhe të vend ndodhjes së personit të shoqëruar, si dhe orën e njoftimit.
- l. Masa e marrë pas verifikimit të rrethanave dhe sqarimin e pozitës të personit të shoqëruar, (këshilluar, gjobitur, arrestuar/ndaluar, lënë i lirë, dërguar për trajtim në qendrat shëndetësore, dërguar pranë gjykatës apo prokurorisë, dorëzuar prindërve/kujdestarit, në qendrat e kujdesit për të miturit, etj).

Punonjësi i shërbimit të informacionit nuk pranon dhe nuk merr në dorëzim personin e shoqëruar pa u plotësuar dhe dorëzuar formulari i raportit të shoqërimit.

Nga DVP Vlorë shtetësja V.B. dhe 9 shtetasit e tjerë janë shoqëruar me qëllim kryerjen e veprimeve procedurale nga strukturat e hetimit të këtij organi në kuadër të procedimit penal të filluar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, por konstatohet se ky veprim nuk është konsideruar si shoqërim në ambientet/mjediset e policisë nga ana e tyre.

Për rrjedhojë nuk është kryer asnjë veprim administrativ për dokumentimin e veprimit të shoqërimit, si: plotësimi i formularit të raportit të shoqërimit nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Himarë, menjëherë pas shoqërimit të tyre në ambientet e DVP Vlorë; evidentimi i të dhënave të të shoqëruarve në sistemin elektronik dhe në regjistrin e evidentimit të personave të shoqëruar pas mbërritjes së të shoqëruarve në ambientet e këtij organi nga punonjësi i zyrës së informacionit të DVP ose Komisarariatit të Policisë Vlorë; përpilimi/hartimi i procesverbaleve të dokumentimit të veprimeve të kryera me personat e shoqëruar dhe dhënia e kopjes së tyre të shoqëruarve nga punonjësit e policisë që kryen veprime me ta, etj.

a.2 – Formulari i Raportit të Shoqërimit

a.2.1 – Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet nga punonjësi i policisë që ka kryer shoqërimin e personit, menjëherë pas shoqërimit të personit në ambientet e policisë/ambientet e shoqërimit.

a.2.2 – Formulari i raportit të Shoqërimit plotësohet në dy kopje dhe pasi plotësohet sipas kërkesave dhe rubrikave të parashikuara në të, i dorëzohet punonjësit të shërbimit të informacionit, i cili e kontrollon për saktësinë dhe korrektësinë e plotësimit

a.2.3 – Nëse nga punonjësi i shërbimit të informacionit konstatohen parregullsi në plotësim ja kthen punonjësit të policisë për ta ri plotësuar dhe njëkohësisht vë në dijen i eprorin e drejtpërdrejtë të punonjësit të policisë.

a.2.4 – Një kopje e Formularit të Raportit të Shoqërimit i jepet punonjësit të policisë që ngarkohet për të sqaruar e trajtuar arsyen/shkakun e shoqërimit dhe zgjedhjen e çështjes për personin e shoqëruar dhe kopja tjetër administrohet nga punonjësi i shërbimit të informacionit i cili në fund të çdo jave i dorëzon në sekretari/arshivën e njësisë policore.

a.2.5 – Formulari i Raportit të Shoqërimit është sipas tipit/modelit të miratuar me urdhër të DPPSH “Për Krijimin e bankës qendrore elektronike për regjistrimin dhe administrimin e te dhënave për personat e shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar”.

a.3 - Procesverbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar:

a.3.1 - Pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.

a.3.2 – Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar.

a.3.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar plotësohet nga punonjësi i policisë që është ngarkuar të kryejë verifikimin dhe trajtimin e çështjes përkatëse për personin e shoqëruar.

a.3.4 - Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimit personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.

Mos plotësimi i procesverbalit dhe mos dhënia e një kopjeje personit të shoqëruar përbën shkelje të rëndë dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Policisë.

Ky fakt provon qartazi konstatimin tonë të herë pas hershëm se nga punonjësit e Policisë së Shtetit nuk njihen dhe nuk zbatohen sa e si duhet aktet normative në fuqi të cilat parashikojnë konceptin e shoqërimit të shtetasve në mjediset e policisë, të drejtat e të shoqëruarve dhe detyrimet e punonjësve të policisë. Sipas pikës 25 të nenit 6 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, **shoqërimi është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji.**

Sipas përkufizimit ligjor, shoqërimi është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë dhe në institucionet e tjera të përcaktuara më sipër me ose pa vullnetin e tij, vetëm në rastet e përcaktuara në ligj. Në këtë kuptim, shoqërimi nuk është dhe nuk duhet kuptuar vetëm ai rast kur shtetasi dërgohet në ambientet e shoqërimit/dhomat e shoqërimit, sikurse e shprehet (kupton apo interpreton) DVP Vlorë, por në çdo ambient/mjedis të strukturave të Policisë së Shtetit, si zyra të punonjësve të policisë, dhoma shoqërimi, dhoma sigurie, etj. Akomodimi i personave të shoqëruar në ambientet e shoqërimit/dhomat e shoqërimit bëhet me qëllim disiplinimin e kësaj veprimtarie, marrjen e të dhënave dhe regjistrimin e tyre në rrugë manuale dhe elektronike, trajtimin human dhe qëndrimin e tyre në kushte dinjitoze në pritje të kryerjes së veprimeve verifikuese për sqarimin e shkakut ligjor për të cilin është bërë shoqërimi dhe të mos qëndrojnë kurrësi në oborre e koridore të godinave të policisë, evidentimin e punonjësve të të policisë që kryejnë veprime me të shoqëruarit, rritjen e sigurisë së të shoqëruarve dhe të vetë punonjësve të policisë, etj.

Theksojmë se rasti në fjalë është një nga rastet tipike të shoqërimit të një shtetasi në ambientet/mjediset e Policisë së Shtetit, sepse referuar edhe përgjigjes së dërguar nga kjo drejtori është ekzekutuar/zbatuar një urdhër i organit të prokurorisë për t’u marrë deklarime shtetasve në fjalë lidhur me një procedim penal, respektivisht me nr. 489, të vitit 2023.

Ky qëndrim/mosveprim vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur me dispozitat e akteve normative të cituara më sipër. Referuar nenit 109/4 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe gjurmës “a.3.4”, të Kreut VII, paragrafi i fundit të Procedurës standarde të punës, mos zbatimi i këtyre detyrimeve ligjore nga personat përgjegjës për dokumentimin e aktit të shoqërimit, **përbën shkelje të rëndë disiplinore dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Policisë.**

Është rasti të theksojnë se shkeljet e të drejtave ligjore të të shoqëruarve nga punonjësit e policisë dhe e detyrimit të këtyre të fundit janë evidentuar edhe më parë nga ana jonë. Ndonëse në disa rekomandime që u janë adresuar në vijimësi nga institucioni i Avokatit të Popullit strukturave vendore e qendrore të Policisë së Shtetit është trajtuar ky shqetësim dhe është rekomanduar përmirësimi i punës, me keqardhje konstatojmë se raste të tilla përsëriten në praktikën e përditshme të shtrukturve vendore.

Ky fakt tregon se nuk njihen në nivelin e duhur aktet normative ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe detyrimet e punonjësve të policisë për të zbatuar e respektuar të drejtat e shtetasve të shoqëruar në mjediset e Policisë së Shtetit.

Gjithashtu vlerësojmë se një ndër shkaqet e përsëritjes së kësaj shkeljeje të të drejtave të qytetarëve është edhe mos ushtrimi i kontrollit të strukturave drejtuese të punonjësve të policisë ndaj vartësve të tyre.

Theksojmë se qëndrimet jo ligjore të mbajtura në këto raste nga punonjësit e policisë cenojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe besimin e publikut tek ky organ, të cilat janë të domosdoshme në kryerjen me sukses të misionit ligjor të saj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi nga strukturat e Policisë së Shtetit, për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve gjatë shoqërimit në ambientet/mjediset e drejtorive/komisariateve/stacioneve të policisë apo në institucione të tjera në përputhje me aktet normative në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme nga DVP Vlorë dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personave përgjegjës për mos zbatimin e detyrimeve ligjore për dokumentimin e veprimit të shoqërimit të shtetasve V.B. dhe të 9 banorëve të tjerë me banim në Himarë dhe Dhërmi, bazuar në nenin 109/4 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe gjurmën “a.3.4”, paragrafi i fundit të Procedurës standarde të punës: “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për ushtrimin e kontrollit në strukturat vendore lidhur me zbatimin e dispozitave të

akteve normative që rregullojnë shoqërimin e shtetasve në mjediset/ambientet e këtij organi dhe respektimit të të drejtave ligjore të të shoqëruarve.

3. Marrjen e masave të nevojshme organizative nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për trajnimin e punonjësve të policisë për njohjen me aktet normative që rregullojnë veprimin administrativ të shoqërimit të shtetasve me mjediset/ambientet e policisë dhe respektimin e të drejtave të shtetasve të shoqëruar.

4. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për përgjithësimin e këtij rasti në strukturat vendore të Policisë së Shtetit me qëllim që shkelje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi